

DIREKTIVA NR. 75/117/KEE, “MBI PËRAFRIMIN E LIGJEVE TË SHTETEVE ANËTARE NË LIDHJE ME APLIKIMIN E PARIMIT TË PAGESËS SË BARABARTË PËR BURRAT DHE GRATË”

10 shkurt 1975

Këshilli i Komuniteteve të Komuniteteve Evropiane,

Duke pasur parasysh Traktatin themelues të Komunitetit Ekonomik Evropian, dhe në veçanti nenin 100 të tij;

Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit;

Duke pasur parasysh Opinionin e Parlamentit Evropian;

Duke pasur parasysh Opinionin e Komitetit Social;

Duke qenë se zbatimi i parimit se burrat dhe gratë duhet të paguhen në mënyrë të barabartë, siç parashikohet në nenin 119 të Traktatit është një pjesë integrale e krijimit dhe funksionimit të tregut të përbashkët;

Duke qenë se është në mënyrë parësore përgjegjësia e shteteve anëtare për të siguruar aplikimin e këtij parimi nëpërmjet ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative të përshtatshme të përshtatshme;

Duke qenë se rezoluta e Këshillit, e datës 21 janar 1974, në lidhje me një program social, që synon mundësimin e harmonizimit të kushteve të jetesës dhe të punës ndërkohë që ruhet përmirësimi, dhe që synon arritjen e një zhvillimi të balancuar ekonomik e social të Komunitetit, ka njohur faktin se prioritet duhet t'i jepet veprimeve të ndërmarra në emër të grave për sa i përket aksesit në punësim, trajnimin dhe zhvillimit profesional, dhe sa i përket kushteve të punës, përfshirë pagesën;

Duke qenë se është e dëshirueshme që të zbatohen ligjet bazë nëpërmjet standardeve që synojnë lehtësimin e aplikimit praktik të parimit të barazisë në mënyrë të tillë që të gjithë të punësuarit e Komunitetit të mund të mbrohen në lidhje me këtë çështje;

Duke qenë se vazhdojnë të ekzistojnë dallime në shumë shtete anëtare të ndryshme pavarësisht nga përpjekjet e bëra për të aplikuar rezolutën e konferencës së shteteve anëtare, të datës 20 dhjetor 1961, në lidhje me pagesën e barabartë për gratë dhe burrat dhe duke qenë se, për pasojë, duhet të përafrohen dispozitat kombëtare për sa i përket aplikimit të parimit të pagesës së barabartë.

Ka miratuar këtë Direktivë:

Neni 1

Parimi i pagesës së barabartë për gratë dhe burrat e parashikuar në nenin 119 të Traktatit, këtej e tutje i quajtur “parimi i pagesës së barabartë”, nënkupton që për të njëjtën punë ose për një punë që ka vlerë të barabartë, të eliminohen të gjithë llojet e diskriminimit për shkak të seksit në lidhje me të gjitha aspektet e kushteve të shpërblimit. Në veçanti, në rastet kur shfrytëzohet një sistem për klasifikimin e punës për të përcaktuar pagën, ky duhet të bazohet në të njëjtat kritere, si për gratë ashtu dhe për burrat, dhe të hartohet në mënyrë të tillë që të përjashtojë diskriminimin për shkak të seksit.

Neni 2

Shtetet anëtare duhet të përfshijnë në sistemet e tyre ligjore kombëtare masa të tilla që janë të nevojshme për t’i mundësuar të gjithë të punësuarve, të cilët pretendojnë se u është bërë një padrejtësi për shkak të mos aplikimit të parimit të pagesës së barabartë, që të ndjekin pretendimet e tyre nëpërmjet proceseve gjyqësore pasi t’i jenë drejtuar autoriteteve të tjera kompetente.

Neni 3

Shtetet anëtare do të shmangin të gjithë format e diskriminimit ndërmjet grave dhe burrave që rrjedhin prej ligjeve, rregulloreve ose dispozitave administrative të cilat janë në kundërshtim me parimin e pagesës së barabartë.

Neni 4

Shtetet anëtare do të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që dispozitat që bëjnë pjesë në marrëveshjet kolektive, shkallët e pagesës, marrëveshjet e pagesës ose kontratat individuale të punësimit, të cilat janë në kundërshtim me parimin e pagesës së barabartë do të konsiderohen ose mund të deklarohen, si të anuluar ose të pavlefshme, ose mund të amendohen.

Neni 5

Shtetet anëtare do të marrin të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur të punësuarit kundër pushimit nga puna prej punëdhënësit, si një reagim ndaj një ankese brenda sipërmarrjes ose kundrejt çdo procedure ligjore që synon arritjen e pajtimit brenda parimit të pagesës së barabartë.

Neni 6

Shtetet anëtare, në përputhje me rrethanat kombëtare dhe sistemet ligjore të tyre, të ndërmarrin masat e nevojshme për të siguruar aplikimin e parimit të pagesës së barabartë. Ato duhet të mundësojnë ekzistencën e masave efektive me qëllim respektimin e këtij parimi.

Neni 7

Shtetet anëtare duhet të kujdesen që dispozitat e miratuara në zbatim të kësaj Direktive, së bashku me dispozitat përkatëse që janë në fuqi, të vihen në vëmendjen e punonjësve me anë të mjeteve të përshtatshme, për shembull në vendin e tyre të punës.

Neni 8

1. Shtetet anëtare do të vënë në zbatim ligje, rregullore dhe dispozita administrative që janë të nevojshme për të qenë në pajtim me këtë Direktivë brenda një viti nga njoftimi i saj dhe do të informojnë për pasojë menjëherë Komisionin.

2. Shtetet anëtare do t'i komunikojnë Komisionit tekstet e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative që do të miratojnë në lidhje me fushën që mbulohet nga kjo Direktivë.

Neni 9

Brenda dy viteve nga data e mbarimit të afatit të periudhës një-vjeçare që i referohet neni 8, shtetet anëtare do t'i transmetojnë të gjithë informacionin e nevojshëm Komisionit me qëllim që t'i mundësojnë atij hartimin e një raporti në lidhje me aplikimin e kësaj Direktive për t'ia paraqitur Këshillit.

Neni 10

Kjo Direktivë i adresohet shteteve anëtare.